



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.1.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike. Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Zyrës së Kryeministrit në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Emine Fazliu e mbështetur nga, Riza Spanca - Udhëheqës Ekipi, Imer Vitija dhe Natyra Kasumaj - Anëtar Ekipi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
2 Qeverisja.....	11
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	19
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	32
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	33
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak	36

Përmbledhje e përgjithshme


Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të ZKM-së për vitin 2015 - i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë Sekretarin e Përgjithshëm dhe Kryeshefat Ekzekutiv të Agjencive dhe stafin për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Në kuadër të këtij auditimi janë përfshirë edhe agjencitë vartëse si: Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (AShAK), Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj), Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës (SKSK) dhe Agjencia për Mbrojtjen nga Rrezatimi Nuklear (AMRRN).

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memorandumin e Planit të Auditimit, e datës 21.10.2015.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes

Pasqyrat vjetore financiare paraqesin *një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale.

Theksim i çështjes

* Nga kategoria e investimeve kapitale gjatë vitit 2015 ishin paguar 1,763,717€, për projektet e AUV-it, të gjitha këto furnizime ishin me artikuj për mallra dhe shërbime si dhe subvencionim i fermerve. Kjo gjendje është shpalosur edhe në PVF.

* Vlera e pasurive jofinanciare mbi 1,000€ e shpalosur në PVF nuk ishte e saktë, kjo pasiqë nuk ishte paraqitur vlera e tokës së AUV-it. në vlerë 1,822,000€.

* Katër subvencione të dhëna nga ZKM në vlerë 31,000€, përfituesit nuk kishin ofruar asnjë dokumentacion (fatura, raporte dhe dëshmi tjera) për të arsyetuar se mjetet e dhëna janë shpenzuar për qëllimin e caktuar.

Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi në pjesën 1.2 të këtij raporti.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:

Subvencionet nuk kontrollohen në mënyrë efektive për të siguruar se ato shpenzohen për qëllimin e caktuar ose që janë dhënë bazuar në kritere të qarta dhe të qëndrueshme.



Duhet të implementohen rregulla të përmirësuara për të siguruar që përfituesit i arsyetojnë shpenzimet e tyre përbrenda një sistemi formal të dhënies dhe monitorimit të subvencioneve.
(shih çështjet 1 dhe 13).

Dobësitë në qeverisje janë duke e penguar menaxhimin efektiv të ZKM-ës.



Kërkohen një sërë veprimesh për ta përmirësuar qeverisjen, përfshirë këtu edhe implementimin më të mirë të rekomandimeve të auditimit, vlerësimin më efektiv të dobësive organizative, mbulueshmëri më të mirë nga auditimi i brendshëm dhe raportimin e përmirësuar financiar dhe operativ.
(Shih çështjet 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7).

AUV kishte paguar shpenzimet që i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime dhe subvencione nga kategoria e investimeve kapitale. Vlera e këtyre pagesave gjatë vitit 2015 ishte 1,763,717€.



ZKA dhe Kryeshefi i AUV-it duhet të insistojnë edhe më tutje, që në bashkëpunim me MF-në të kërkojnë zgjidhje për keqklasifikimin aktual të shpenzimeve (shih çështjen 8).

Ekzistojnë një sërë mangësish që ndërliken me kategori të shpenzimeve e të cilat në disa raste, potencialisht, mund të ndikojnë në humbje financiare për ZKM.



Duhet të forcohen mekanizmat e kontrollit të brendshëm që ti adresojnë dështimet e prokurimit dhe proceset që përforcojnë shpenzimet pa prokurim. (shih çështjet 9, 10 dhe 11).

Regjistrimi i pasurive nuk ka përfunduar tërësisht dhe ka mospërputhje mes pasurisë aktuale dhe të atyre që janë regjistruar në e-pasuria.



Proceset e menaxhimit të pasurisë duhet të përmirësohen për të siguruar se baza e pasurisë është regjistruar saktë/drejtë. Për ta arritur këtë duhet të prioritizohet koha e stafit. (shih çështjen 15).

Përgjigja e Menaxhmentit të ZKM-së - auditimi 2015

Menaxhmentit të ZKM-së ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë, me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

Opinioni i pamodifikuar me Theksim të Çështjes

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Zyres së Kryeministrit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat vjetore financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, të pranimeve dhe të pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të Zyres së Kryeministrit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjin nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë i plotësuar dhe i ndryshuar (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare të Ministrisë së Financave nr. 03/2013/ për pasqyrat vjetore financiare të organizatave buxhetore.

Bazë për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNISA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në përgjegjësitë e auditorit në pjesën e raportit tonë për auditimin e Pasqyrave Financiare. Në jemi të pavarur nga Zyra e Kryeministrit, në përputhje me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që i kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazë për opinionin tonë.

Theksimi i çështjes

Dëshirojmë ta tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Nga kategoria e investimeve kapitale gjatë vitit ishin paguar 1,763,717€, për projektet e AUV-it, të gjitha këto furnizime ishin me artikuj për mallra dhe shërbime si dhe subvencionim i fermerve. Kjo gjendje është shpalosur edhe në PVF;
- Vlera e pasurive jofinanciare mbi 1,000€ e shpalosur në PVF nuk ishte e saktë, kjo pasiqë nuk ishte paraqitur vlera e tokës së AUV-it. Pas rekomandimeve të vazhdueshme, AUV me datë 26.04.2016 kishte arritur të regjistronte tokën në vlerë 1,822,000€;
- Në katër subvencione të dhëna nga ZKM në vlerë prej 31,000€, përfituesit nuk kishin ofruar asnjë dokumentacion (fatura, raporte dhe dëshmi tjera) për të arsyetuar shpenzimin e mjeteve të dhëna.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Menaxhmenti i ZKM-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollen të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Zyrtari Kryesor Administrativ(ZKA) është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Zyrës së Kryeministrit.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.3 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në Memorandumin e planit të auditimit, të datës 21.10.2015, është identifikuar një rrezik që ndërlidhet me procesin e dhënies dhe arsyetimit të subvencione. Një theksim i çështjes nga 2014 ka pasqyruar mungesë të dëshmive të mjaftueshme nga të subvencionuarit për të demonstruar se subvencionet e paguara janë shpenzuar për qëllimin e caktuar.

Rreziku i identifikuar

Çështja 1- Mungesa e dëshmive për arsyetimin e shpenzimeve nga përfituesit e subvencioneve - Prioritet i lartë

Përgjigja dhe të gjeturat e auditimit

Gjatë procesit të auditimit ne kemi analizuar kontrollet e vendosura nga menaxhmenti, në mënyrë që të sigurohemi se subvencionet e dhëna janë shpenzuar për qëllimin e caktuar. Derisa në 2015 janë aplikuar kontrolle të përmirësuara, kemi identifikuar katër subvencione në total prej 31,000€, ku nuk është paraqitur asnjë dokumentacion (fatura, raporte dhe dëshmi tjera) për të konfirmuar se fondet janë shpenzuar për qëllimin e caktuar. Kjo pasqyron një qasje jokonsistente nga ZKM në kërkesën e tyre për dokumentacionin e nevojshëm.

Rekomandimi 1 ZKA në bashkëpunim me Drejtorin e Zyrës për Çështje të Komuniteteve duhet të forcojë edhe më tutje kontrollet mbi subvencione duke implementuar dhe aplikuar kërkesa strikte për dëshmitë që duhet të ofrohen nga përfituesit me rastin e pranimit të mjeteve të subvencionit. Duhet ti jepet konsideratë edhe vendosjes së kërkesës ndaj përfituesve për kthimin e fondeve në rastet ku nuk janë ofruar dëshmi të përshtatshme/duhura.

1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Nga ZKM kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me ligjin nr.03/L-221, ligjin nr. 04/L-116 dhe ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore;
- Kërkesat që PVF-të të nënshkruhen nga ZKA dhe ZKF, si dhe dorëzuar në MF;
- Kërkesat e Rregullores 01/2013 - Shpenzimi i parave publike dhe Rregullores nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurive jo financiare.

Në kontekst të PVF-ve, çështjet e ngritura në memon e auditimit të ndërmjetëm, të datës 01.12.2015, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga menaxhmenti.

Në Pasqyrat Vjetore Financiare ishin të nevojshme disa korrigjime, lidhur me plotësinë dhe saktësinë e tyre. Pas sugjerimeve tona, ishin bërë disa korrigjime që kishin të bënin me çështjen si në vijim:

- *Neni 12 – pasqyra e pranimeve dhe pagesave – shfrytëzimi i fondeve për kategoritë mallra dhe shërbime si dhe subvencione dhe transfere ishin mbivlersuar për vlerën 10,970€ përkatësisht 4,000€.* Këto kryesisht e kanë pasqyruar ndikimin e korrigjimeve të fundit nga Ministria e Financave.

Përderisa tek neni 16 shpalojsja e pasurive nuk ishte paraqitur vlera e tokes së AUV-it. Pas rekomandimeve të vazhdueshme, AUV me datë 26.04.2016 kishte arritur të regjistronte tokën në vlerë 1,822,000€.

Marrë parasysh korrigjimet e kryera – Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të PVF-ve në Qeveri, me përjashtim të çështjes së shpalojsjeve të pasurisë mund të konsiderohet e drejtë dhe e vërtetë.

Përveç hartimit të PVF-ve, nga ZKM kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesat Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë edhe pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Raportet operative;
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit;
- Raportimin mujor të obligimeve të papaguar; si dhe
- Raportin mbi kontrollat e brendshme, përfshirë raportin e vetvlerësimi, e të tjera.

Ne nuk kemi çështje për të ngritur në lidhje me këto. Të gjitha raportet janë dorëzuar në MF dhe në institucionet tjera përkatëse brenda afateve kohore.

Rekomandim

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për ZKM-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballlet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore, siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të:

- Ato fusha të Aranzhimeve të Qeverisjes ku nevojiten përmirësime domethënëse dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuarra përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda ZKM-së veçanërisht në lidhje me implementimin e rekomandimeve nga auditimi i vitit paraprak (përfshirë rekomandimet nga auditimi i brendshëm), strukturat e dobëta të llogaridhënies, mungesa e proceseve formale për menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Lista kontrolluese e vetvlerësimit, e plotësuar nga ZKM dhe agjencitë vartëse e pasqyron situatën vetëm pjesërisht me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese që nuk bazohen në dëshmi.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 ka rezultuar në 18 rekomandime. ZKM ka përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen të gjitha rekomandimet, megjithatë, në fund të auditimit tonë për vitin 2015, ZKM kishte arritur të implementojë vetëm dy rekomandime, gjashtë janë adresuar dhe 10 nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 2 - Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- E gjetura** Vetëm një numër i vogël i rekomandimeve të vitit të kaluar janë implementuar, kjo sepse ZKM nuk ka zbatuar një proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar në baza periodike implementimin e rekomandimeve.
- Rreziku** Dështimi për ti implementuar rekomandimet e auditimit ka rezultuar në vazhdimësinë e dobësive në kontrollin e brendshëm dhe në dobësi të tjera në qeverisje të cilat e zvoglojnë efektivitetin operativ të ZKM-ës. Këto kanë ndikuar në;
- Përsëritjen e mangësive në kategorinë e subvencioneve;
 - Pagesat e funizimeve për mallra dhe shërbime nga kategoria e investimeve kapitale.
- Rekomandimi 2** ZKA në bashkëpunim me Kryeshefat Ekzekutiv të Agjencive duhet ta prioritetizojnë implementimin e rekomandimeve të auditimit dhe të sigurohen se një plan veprimi menaxhohet në mënyrë proaktive dhe i cili detajon stafin përgjegjës dhe orarin për implementimin e secilit nga rekomandimet. Implementimi i planit të veprimit duhet të rishikohet nga ZKA në baza mujore.

2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar një nga një pyetjet kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese.

Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për ZKM-në dhe Agjencitë vartëse më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin Vjetor të Auditimit të ZAP-it. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për ti mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 3 – Lista kontrolluese e vetvlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura

Si pjesë e auditimit, i kemi shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponente. Për pyetjet e shqyrtuara dhe rishikimi i listës kontrolluese të vetvlerësimit kemi gjetur se:

- Për secilën pyetje, ZKM ka deklaruar se kontrolli përkatës ka qenë i vendosur/funksional, por “nota” e dhënë nuk ka qenë e mundur të dëshmohet. Kjo pasqyron se kërkesat nga lista kontrolluese e vetvlerësimit nuk është kuptuar qartë nga ZKM dhe agjencitë, dhe kjo ka rezultuar edhe në mbivlerësim edhe në nënvlerësim të notave;
- Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosur në ZKM dhe agjencitë e saj dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.2;
- Proceset efektive të monitorimit si dhe strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit (përfshirë ndërlidhjen me palët e interesit si dhe sigurimin e strategjisë me kosto të plotë) nuk konsiderohen si plotësisht të vendosura nga ZKM, kjo pasi që AUV-i dhe ASHAK-u ende nuk kishin të aprovuar strategjinë. Çështjet e monitorimit po ashtu janë shqyrtuar më hollësisht në nënkapitullin 2.5.3.

Rreziku

Poentimi jo i saktë i listës së vetvlerësimit e parandalon ZKM-në t’i identifikoj çështjet e rëndësishme të qeverisjes të cilat kërkojnë përmirësim dhe i vonon veprimet e ndërmarra për ti adresuar ato. Ngjashëm, në qoftë se një pozicion Ministrisë së Financave i paraqitet gabimisht, nevojat për ndryshime dhe mundësitë për zhvillim mund të mos identifikohen, duke vonuar kështu përmirësimet e nevojshme të qeverisjes.

Rekomandimi 3

ZKA dhe Kryeshefat Ekzekutiv duhet të sigurojnë se lista kontrolluese e vetvlerësimit është kuptuar plotësisht nga i gjithë stafi i përfshirë në plotësimin e tyre dhe të sigurojnë se është aplikuar një rishikim mbikqyrës para se të dorëzohet në Ministrinë e Financave, për të siguruar se përgjigjet janë të bazuara në dëshmi.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit ZKM operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Aranzhimet e llogaridhënies

ZKM ka një numër Agjencish Ekzekutive, PVF-të e të cilave janë konsoliduar në PVF-të e ZKM-së. Për të siguruar një menaxhim financiar efektiv nevojitet një proces efektiv i konsolidimit dhe raportimit me kohë.

Çështja 4 - Proceset e llogaridhënies - Prioritet i lartë

- E gjetura** ZKM është përgjegjëse për të gjitha aktivitetet financiare dhe menaxheriale të agjencive të saj vartëse¹. Raportimi i brendshëm dhe linjat e llogaridhënies ndërmjet ZKM-së dhe agjencive ekzekutive, vazhdojnë të jenë një sfidë e veçantë. Procesi i konsolidimit të PVF-ve nuk ishte efektiv për shkak të linjave të papërshtatshme të llogaridhënies. Kryeshefat Ekzekutiv të Agjencive raportojnë tek Kryeministri apo Zëvendës Kryeministri përkatës, derisa Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së është përgjegjës për pasqyrat e konsoliduara financiare. Për qëllime të konsolidimit të informatave dhe raporteve financiare, agjencitë dërgojnë raporte në departamentin e financave në ZKM, mirëpo nuk ka ndonjë rishikim efektiv të këtyre raporteve për shkak të aranzhimeve të dobëta të llogaridhënies.
- Rreziku** Raportet e dobëta të llogaridhënies dhe mungesa e kontrolleve efektive në raportimet financiare mund të rezultojnë në dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare dhe operative me kohë. Si rezultat i mangësive në llogaridhënie, raportimi i obligimeve mujore nuk paraqiste gjendjen e saktë të tyre.
- Rekomandimi 4** ZKA duhet të sigurojë një rishikim të kërkesave ekzistuese të llogaridhënies dhe të raportimit ndaj agjencive ekzekutive si dhe të siguroj aranzhime të përmirësuara për të arritur objektivat e vitit 2016.

¹ Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (AShAK), Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj), Sekretariati i Këshillit të Sigurisë i Kosovës (SKSK) dhe Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore (AKMRSB)

2.5.2 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë proceset e menaxhimit të rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara me procedurat e MFK dhe rregullës 01/2010 kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

Çështja 5 - Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut- Prioritet i lartë

- E gjetura** ZKM dhe Agjencitë e saj ende nuk kishin hartuar regjistra ku do të identifikoheshin dhe vlerësoheshin qartë të gjitha rreziqet e mundshme në drejtim të arritjes së objektivave të tyre operative.
- Rreziku** Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëloj cilësinë e shërbimeve për qytetar, kjo pasi që rreziqet e brendshme dhe të jashtme ndikojnë negativisht nëse nuk adresohen me kohë dhe në mënyrë sistematike dhe të planifikuar.
- Rekomandimi 5** ZKA dhe Kryeshefat Ekzekutiv duhet të sigurojnë se kërkesat për menaxhim të rrezikut janë vlerësuar dhe se përgjegjësia për aspektet kyçe të kësaj është deleguar tek zyrtarët përkatës. Aty ku është e përshtatshme, për stafin përkatës duhet të ofrohet trajnim. Regjistrat e rrezikut dhe veprimet e ndërmarra për lehtësimin e rrezikut të identifikuar duhet të rishikohen nga ZKA në baza periodike.

2.5.3 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 6 – Dobësi në Kontrolllet Menaxheriale – Prioritet i lartë

- E gjetura** Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar të ZKM-së ka nxjerrë në pah një raportim të kualitetit të dobët tek menaxhmenti i lartë mbi shpenzimet, si dhe analiza jo të plota lidhur me arritjen e objektivave. Kjo ka ndodhur për shkak se formati i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth diferencave në buxhet dhe për parashikimet buxhetore, në të njëjtën kohë edhe arritja e objektivave operationale nuk raportohet në baza të rregullta.
- Rreziku** Raportimi financiar i cilësisë së dobët do ta reduktoj efektivitetin e menaxhimit financiar brenda ZKM-së për të siguruar se rezultatet e pritura janë arritur në mënyrë efikase përkundër burimeve të pamjaftueshme.
- Rekomandimi 6** ZKA dhe Kryeshefat Ekzekutiv duhet të sigurojnë se është kryer një rishikim për të përcaktuar përmbajtjen dhe formën e raportimit që kërkohet për ta mbështetur menaxhimin efektiv të ZKM-ës dhe agjencive vartëse. Dokumentacioni i azhurnuar duhet të përfshijë shënime të detajuara sqaruese të cilat sqarojnë arsyet për të gjitha variancat, përveç atyre të vogla, dhe ofrojnë bazën për rishikimin e arritjeve operative në baza të rregullta (së paku në baza mujore).

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) gjatë vitit 2015 ka funksionuar me një staf – që ishte edhe Drejtor i NjAB. NjAB kishte përgatitur planin vjetor të auditimit duke e koordinuar me planin strategjik të njësisë dhe hartuar në bazë të vlerësimit të rrezikut në kontekst të burimeve në dispozicion.

Për vitin 2015, NjAB kishte planifikuar të kryente këto auditim: Menaxhimi i ZKM-së, Menaxhimi i AUV-it, Menaxhimi i ABGJ-së si dhe Menaxhimi i ASK-së. Prej këtyre auditimeve të planifikuara auditimi “Menaxhimi i ASK-së” nuk ishte kryer gjatë vitit, ky raport ishte përfunduar në mars 2016.

Komiteti i Auditimit (KA) kishte mbajtur tri takime gjatë vitit dhe kishte marrë parasysh edhe raportet e ZAP-it dhe të Auditimit të Brendshëm.

Çështja 7 - Mungesa e stafit në NjAB - Prioritet i mesëm

E gjetura

Ekzistonë një numër dobësisish në lidhje me operacionet aktuale të NJAB:

- Për shkak të numrit të madh të agjencive vartëse, ZKM konsiderohet si një organizatë komplekse. Një auditor i vetëm e ka të pamundur të jetë në gjendje të ndërmarrë një shqyrtim të mjaftueshëm të plotë të një organizate të tillë. UA 23/2009 sugjeron se duhet të ketë tre auditor të brendshëm për një organizatë të madhësisë së ZKM-së dhe Komiteti i Auditimit e ka komentuar pozicionin aktual që pasqyron vendimin nga Zyra e Kryeministrit për plotësim të përgjithshëm me staf; dhe
- Në tre raporte të përfunduara në 2015, NJAB ka dhënë në total 28 rekomandime nga këto vetëm tetë rekomandime janë implementuar nga ana e menaxhmentit.

Këto rezultate pasqyrojnë mungesën e prioritizimeve nga Menaxhmenti për punën e NJAB-ës.

Rreziku

Mungesa e stafit të NjAB-ës do të rezultojë në një program joefektiv të punës, i cili nuk arrin ti jap siguri menaxhmentit ose anasjelltas për funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme në të gjithë organizatën. Dobësitë që nuk identifikohen nuk do të trajtohen, duke rezultuar në operacione joefektive dhe performancë të dobët. Dështimi për ta adresuar implementimin e rekomandimeve të NJAB-ës do të rezultojë që dobësitë e identifikuara të kontrollit të mos adresohen dhe në humbje të mundshme financiare për ZKM-ën.

Rekomandimi 7

ZKA duhet të kërkojë ti zgjidh/prioritizoj çështjet ekzistuese lidhur me personelin shtesë për të mundësuar punësimin e numrit të nevojshëm me auditor të brendshëm. Duhet të bëhet një rishikim i rregullt (të paktën çdo dy muaj) i zbatimit të rekomandimeve të AB-ës dhe KA.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të forta dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive - por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim. Procesimi i pagesave, prokurimi, menaxhimi i obligimeve dhe menaxhimi i pasurisë mund të përmirësohen konsiderueshëm.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për ZKM-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Burimet e Fondeve:	12,716,516	10,767,573	9,848,779	10,090,142	9,275,391
Granti i Qeverisë -Buxheti	12,362,882	9,681,122	9,303,190	9,418,659	8,785,284
Të bartura nga viti paraprak ³ -	0	152,296	109,837	190,652	100,129
Të hyrat vetjake ⁴	353,634	353,634	187,790	140,831	166,087
Donacionet e brendshme	0	19,547	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	560,974	247,962	340,000	223,891

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 1,948,943€. Ky buxhet ishte rezultat i shumë përshtatjeve dhe ndryshimeve gjatë vitit 2015. Në njërin anë fondet nga granti Qeveritar ishin zvogëluar, në anën tjetër buxheti nga të hyrat vetanake, donacionet e brendshme dhe donacionet e jashtme kishin ndikuar në rritjen e buxhetit.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Pas korrigjimeve, realizimi i buxhetit ishte rreth 91% nga buxhetit final, me një përmirësim prej 7% krahasuar me vitin 2014. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,2716,516	10,767,573	9,848,779	10,090,144	9,275,388
Pagat dhe Mëditjet	4,536,957	4,315,866	4,244,411	3,885,134	3,192,556
Mallrat dhe Shërbimet	2,980,732	3,630,593	2,933,865	2,836,490	3,360,023
Shërbimet komunale	207,133	124,173	123,965	134,430	119,895
Subvencionet dhe Transferet	1,480,000	920,314	782,821	1,512,375	1,173,989
Investimet Kapitale	3,511,694	1,776,627	1,763,717	1,721,715	1,428,925

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti për paga dhe mëditje është reduktuar për 221,091€, ky reduktim ishte rezultat i disa ndryshimeve gjatë vitit. Kjo kategori me rishikim të buxhetit ishte zvogëluar për 282,376€, ndërsa me përshtatje nga MF ishte zvogëluar për 31,745€. Në anën tjetër kishte pasur rritje nga donacionet për 57,610€ si dhe 35,420€ për fondin për kuadro;
- Buxheti i ndarë për kategorinë mallra dhe shërbime ishte rritur për 649,860€, kjo rritje ishte reflektim i këtyre ndryshimeve gjatë vitit: me vendime të Qeverisë për përkrahjen e aktiviteteve të ndryshme kjo kategori është rritur për 401,700€, nga donacionet 188,013€, si dhe nga të hyrat e bartura për 148,510€, përderisa si rezultat i rishikimit dhe përshtatjeve të vazhdueshme nga MF ishte reduktuar për 88,363€. Po ashtu buxheti për shërbime komunale ishte reduktuar 82,960€;
- Buxheti për subvencione dhe transfere ishte reduktuar për 559,686€. Fillimisht buxheti ishte rritur nga donacionet në vlerë 323,658€, si dhe për organizimin e shtatë vjetorit të Pavarësisë 50,000€. Përderisa nga përshtatjet buxhetore të vazhdueshme ishte reduktuar për 839,104€. Zyra për çështje të komuniteteve si pjesëmarrësi më i madh i subvencioneve në kuadër të ZKM-së kishte të paplotësuar pozitën e drejtorit të kësaj zyrë gjë që ka ndikuar në aprovim më të ulët të kërkesave për subvencionim. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 85%; dhe

- Buxheti fillestar për investime kapitale ishte reduktuar në total për 1,735,067€. Prej tyre 1,000,000€ kishin qenë të ndara edhe këtë vit për projektin e AUV-së me bashkëfinancim me zyrën e BE-së⁵. Projekti nuk kishte filluar për shkak të vonesave që ndërlihdeshin me shpronësimin e lokacionit të fabrikës. Shumën prej 400,000€ AUV e kishte deklaruar si kursime nga katër⁶ projekte për të cilat kishin marrë zotime nga donatorët për financim. Gjatë reduktimeve të fund vitit MF kishte zvogëluar buxhetin nga mjetet e lira të AUV-it për 345.432€. Në anën tjetër ZKM kishte marrë buxhet nga donacionet në vlerë prej 10,365€.

Tabela 3. Të hyrat e inkasuara për buxhetin e Kosovës (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat vetanake	353,634	505,930	5,627,251	5,287,972	4,826,775
Donacionet	0	0	299,080	107,500	664,894
Totali	353,634	505,930	5,926,331	5,395,472	5,491,669

Të hyrat vetanake prej 505,930€ ishin lejuar të shpenzoheshin për nevojat e AUV-it dhe ASHAK-ut. Të hyrat e vitit 2015 krahasuar më vitin 2014 ishin rritur për 530,859€. Rritja ishte rezultat i shtimit të aktivitetit të AUV-it në inspektime dhe përkrahja më e madhe nga donatorët në drejtim të agjencive të ZKM-së.

⁵ Bashkëfinancimi i projektit “ Ndërtimi i fabrikës së riciklimit të mbeturinave shtazore” në vlerë 7,700,000€ në mes të Qeverisë dhe zyrës së BE-së (5.7 mil. Financuar nga BE-ja si dhe 2 mil€ nga Qeveria e Kosovës).

⁶ Shuma 200,000€ nga projekti “Blerja e pajisjeve për laborator”, nga projekti “Ndërtimi i pikave në kufi” janë kursyer 150,000€, kurse nga projekti “Siguria e ushqimit” dhe “Blerja e pajisjeve të inspektoratit” ishin kursyer në total 50,000€.

Çështja 8 - PAGESA E FURNIZIMEVE ME MALLRA DHE SHËRBIME NGA INVESTIMET KAPITALE - PRIORITYET I LARTË

- E gjetura** Furnizimet e ndryshme për projektet⁷ në AUV ishin buxhetuar nga MF dhe paguar nga investimet kapitale, përderisa rregullat e thesarit këto lloje furnizimesh i kategorizojnë si mallra dhe shërbime. Vlera e këtyre furnizimeve gjatë vitit 2015 ishte 1,763,717€, kjo kishte ndikuar të mbivlerësoheshin investimet kapitale dhe të nënvlerësoheshin mallrat dhe shërbimet si dhe subvencionet. AUV që nga viti 2007 kishte bërë përpjekje që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave (MF) të korrigjojnë kategorinë buxhetore, por nuk ishte arritur të adresohet nga MF. Kjo çështje ishte shpalosur në detaje në PVF-të.
- Rreziku** Keqklasifikimi i buxhetit rezulton në prezentim jo të drejtë të të dhënave në PVF dhe që ky gabim të ripërsëritet edhe në Pasqyrat e Konsoliduara të Buxhetit të Kosovës.
- Rekomandimi 8** ZKA dhe Kryeshefi i AUV-it duhet të insistojnë edhe më tutje në bashkëpunimin me MF-in për të kërkuar zgjidhje për keqklasifikimin material aktual të shpenzimeve. Ky bashkëpunim duhet të theksojë vlerat relative të cilat paraqesin rrezikun që nga auditori i jashtëm të jep një opinion të modifikuar.

3.4 Prokurimi

Qëllimi i kornizës ligjore dhe rregullave financiare në lidhje me prokurimin kanë për qëllim të sigurojnë se mjetet publike janë përdorur në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Ne testuam 15 procedura të prokurimit si dhe 109 pagesa në vlerë totale 1,256,922€, nga të cilat rezultuan mangësitë e mëposhtme.

Çështja 9 - Dobësi sistematike në pagesat përmes prokurimit - PRIORITYET I LARTË

- E gjetura** LMFPP si dhe rregulla financiare 01/2013 përcaktojnë hapat që duhet ndjekur në procesimin e pagesave nga buxheti.
- Nga shqyrtimi i pagesave të ekzekutuara kemi identifikuar këto dobësi:
- Në 84 raste zotimi së bashku me urdhërblertet në vlerë totale 792,062€, si dhe në 11 raste urdhërblertet në vlerë totale prej 68,964€, ishin përgatitur pas pranimit të furnizimeve të mallrave dhe shërbimeve, përkatësisht pas pranimit të faturës. Kjo kishte ndodhur pasi që stafi i përfshirë në këtë

⁷ Projekti për "Mbrotjtja e shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve", "Parandalimi dhe trajtimi i etheve hemorragjike", "Siguria e ushqimit" si dhe disa projekte të tjera të kësaj natyre. Këto projekte me këtë keqklasifikim kanë filluar në vitin 2007 dhe vazhdonë edhe më tutje.

proces nuk i kishte të qarta kërkesat ligjore për procesimin e pagesave hapat që duhet të ndjekur deri tek finalizimi i pagesave; dhe

- Në ASHAK ishin procesuar tre pagesa në total 10,570€ pa u protokolluar faturat e pranuar. Kjo kishte rezultuar pasi që ASHAK ende nuk e kishte të vendosur praktiken e protokollimit të faturave siç kërkohet me rregullën financiare;

Rreziku

Dështimi në aplikimin e procesit të kërkuar për pagesa dhe mos protokollimi i faturave mund të rezultoj në rritje të obligimeve të paplanifikuara dhe në dështim të arritjes së caqeve të pagesës. Kur financohen obligimet e paplanifikuara, obligimet e planifikuara mund të mos përmbushen..

Rekomandimi 9

ZKA dhe Kryeshefat Ekzekutiv duhet ti analizojnë arsyet e lëshimeve procedurale të identifikuar të cilat rezultojnë në dobësi sistematike të prokurimit dhe të shtojnë kontrollet për të evituar përsëritjen e tyre në të ardhmen.

Çështja 10 – Dobësitë jo-sistematike të prokurimit – Prioritet i lartë

E gjetura

Nga rishikimi i procedurave të prokurimit, kemi identifikuar se disa kontrolle ndaj aktiviteteve të prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë si rezultat i menaxhimit të dobët të prokurimit dhe kjo ka rezultuar si më poshtë:

- ZKM së bashku me agjencitë këtë vit kishin shpenzuar 113,043€ për shpenzime të telefonisë mobile. Këto mjete ishin shpenzuar për shpërndarjen e kartelave mbushëse në bazë të UA për shpenzime të telefonisë kur një vlerë më e mirë për parane mund të arrihet përmes tenderimit të hapur;
- Si rezultat i ndryshimeve të shpeshta në staf dhe pamundësisë për planifikim të saktë, në ZKM ishin zhvilluar tetë procedura të prokurimit, të ndara në periudha të ndryshme, për furnizim me mallrat e teknologjisë informative me vlerë totale 18,218€ dhe në këtë mënyrë është shmangur konkurrenca;
- Neni 61 i LPP kërkon që nëse një operator ofron çmim jo-normalisht të ulët në ndonjë artikull, autoriteti kontraktues i dërgon një kërkesë për shpjegim operatorit, dhe analizon më tutje për të marrë vendim. ASK kishte nënshkruar kontratë kornizë për tre vite në vlerë 497,168€, pa dërguar letër për shpjegim te përfituesi i kontratës “Intervistimi dhe

grumbullimi i të dhënave statistikore në teren” edhe pse kishte një artikull më çmim jo-normalisht⁸ të ulët dhe mjaft të rëndësishëm;

- Në tre kontrata në AUV, menaxherët e përcaktuar të kontratave nuk kishin përgatitur planin për menaxhimin e tyre ashtu sic kërkohet nga LPP;
- Edhe pse LPP e ndalon që në specifikacionin teknik të dosjes së tenderit, të precizohet prodhuesi i pajisjes, kjo kishte ndodhur në SKSK në kontratën “Furnizim me Kompjuter “në vlerë 8,405€. Kjo për shkak të ndjeshmërisë së institucionit si dhe kërkeses së furnizimit me pajisje më kualitative;
- Kontrata “Furnizim me kite, reagjent dhe material shpenzues”, ishte e ndarë në 10 Lote. Kontrata për Llotin e nëntë ishte nënshkruar me operatorin i cili kishte ofertuar me çmim për 2,370€ më shtrenjtë se ofertuesi tjetër i përgjegjshëm. Kjo kishte ndodhur si rezultat i punës së cilësisë së dobët të bërë nga komisioni i vlerësimit.

Rreziku

Shpenzime domethënëse të bëra pa zbatuar proces të prokurimit, ndarja e blerjes në lloje, specifikimi i markës së pajisjeve të nevojshme, dhe dështimi për të identifikuar kuotën më të lirë do të rezultojnë në vlerë të dobët për para dhe në humbje financiare. Nënshkrimi i kontratave pa analizuar çmimin jo-normalisht të ulët mund të rezultojë që shërbimet të mos ofrohen në sasi dhe cilësinë e kërkuar. Mungesa e një plani për menaxhimin e kontratës mund të rezultojë në dështim në zbatimin e kontratave.

Rekomandimi 10 ZKA dhe Kryeshefat Ekzekutivë të sigurojnë zbatimin e një rishikimi të brendshëm për të përcaktuar se pse nuk zbatohen kërkesat e prokurimit për të arritur një efekt më të mirë për ZKM. Rrjedhimisht, duhet të prezantohen kontrole të përmirësuara në mënyrë që të sigurohet se dobësitë jo sistematike të theksuara më lartë janë adresuar dhe nuk janë përsëritur.

⁸ Kontrata përmbante tetë artikuj. Por artikulli “Anketa –monitorimi i çmimeve prej 1-110 pyetje” i paralogaritur në 180,000 njësi, nga fituesi ishte ofertuar me vlerë 0.13 €/njësi, kurse konkurrenti kishte ofruar me çmim 2€/njësi. Andaj krahasuar me çmimin e konkurrentit dhe çmimet e llojeve tjera të anketave ky çmim dukej jo-normalisht i ulët.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Shpenzimet jo përmes prokurimit nënkuptojnë të gjitha ato blerje të cilat nuk kërkojnë aplikimin e procedurave të prokurimit publik. Për këtë lloj të shpenzimeve ne testuam 23 pagesa në vlerë totale prej 123,839€. Këto pagesa ishin për avancet e udhëtimeve jashtë vendit, pagesat për angazhime të veçanta si dhe pagesa për mallra dhe shërbime, ku identifikuam mangësitë si në vijim:

Çështja 11 - Vonesa në mbylljen e avanceve dhe kompensimet e punonjësve nga mallrat dhe shërbimet - Prioritet i lartë

E gjetura UA 2004/07 për udhëtime zyrtare specifikon se avancet duhet të mbyllen 15 ditë pas kthimit nga udhëtimi zyrtar dhe shumat e pashpenzuara të kthehen në llogari. Nga testimi i avancave kemi vërejtur se 26 avance në vlerë totale prej 77,235€, ishin mbyllur pas afatit ligjor. Vonesat në mbyllje varionin deri në 10 muaj pas afatit ligjor.

Sipas Ligjit Nr.05/L-001 për buxhetin e vitit 2015, nuk lejohet kompensimi i nëpunësve civil nga kategoria për mallra dhe shërbime. ASK duke u thirrur në aktin nënligjor të saj UA nr.08/2012 edhe këtë vit kishte kompensuar 84 nëpunës të saj në total 64,238€ gjë që është në kundërshtim me ligjin. Gjatë vitit 2015 ishte iniciuar plotësim ndryshimi i këtij UA nga ana e ASK, por që ende nuk kishte kaluar për aprovim në Qeveri.

Rreziku Mungesa e kontrolleve efektive në mbylljen e avanceve rrisin rrezikun që mjetet mos ti kthehen ZKM-së dhe të shfrytëzohen në mënyrë të papërshtatshme. Klasifikimi i gabueshëm i shpenzimeve mund ta drejtoj lexuesin e pasqyrave financiare në drejtim të gabuar dhe ta dëmtoj kontrollin efektiv buxhetor. Poashtu mund të rezultoj në pagesa të parregullta.

Rekomandimi 11 ZKA duhet të sigurojë se janë aplikuar kontrolle efektive për të siguruar se të gjitha avancet mbyllen brenda afatit ligjor. Përderisa Kryeshefi i ASK-së të sigurojë se të gjithë nëpunësit kompenzohen vetëm nga kategoria e paga dhe mëditjeve.

3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Ne rishikuar transaksionet sipas listës së pagave ku vërejtëm se divizioni i financave është njoftuar rregullisht dhe me kohë lidhur me ndryshimet në paga dhe mëditje.

Gjatë vitit, ZKM dhe agjencitë e saj kishin kryer rekrutime të stafit. Ne kemi përzgjedhur dhe analizuar shtatë procedura të rekrutimit. Po ashtu testuam edhe mostra duke përfshirë dosjet e të punësuarve të cilat ishin mbajtur dhe azhurnuar rregullisht nga zyra e personelit, varësisht prej ndryshimeve të ndodhura të stafit të punësuar.

Çështja 12 - Mbulimi i pozitës me ushtrues detyre më gjatë se afati ligjor - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Ligji i Shërbimit Civil nr.03-L-149, përcakton se një pozitë nuk mund të mbahet nga ushtruesi i detyrës për më shumë se tre muaj. Një rast në AUV pozita menaxhuese mbahej nga ushtruesi i detyrës që nga muaji maj 2015.
- Rreziku** Zyrtarët “ushtrues detyre” mund të mos jenë personeli më efektiv që ti adresojne sfidat që paraqesin pozita të caktuara duke e reduktuar kështu efektivitetin e operacioneve të organizatës.
- Rekomandimi 12** ZKA dhe Kryeshefi Ekzekutiv duhet të sigurojnë se për poziten e udhëhequr me ushtrues detyre bëhet një zgjidhje e qëndrueshme dhe në pajtim me kërkesat ligjore.

3.5.2 Subvencionet dhe Transferet

ZKM gjatë vitit 2015 kishte dhënë subvencione për qëllime të ndryshme siç ishin ato për kthim të minoriteteve, për projekte në bashkëpunim me Komunat, manifestime të ndryshme⁹, për përkrahjen e OJQ dhe mediave të komuniteteve, aktivitete për të pagjeturit etj.

Subvencionet e dhëna ishin në vlerë totale 782,821€, pjesëmarrje më të madhe kishte Zyra për Çështje të Komuniteteve në vlerë 628,195€, ndërsa Zyra e Kryeministrit dhe agjencitë tjera në total prej 154,625€.

Për vitin 2015 testuam 24 pagesa në vlerë 422,949€. Rreziku domethënës i identifikuar në këtë kategori është përshkruar në nënkapitullin 1.3.

Çështja 13 - Mungesa e rregullores–Prioritet i lartë

E gjetura Në 2015 ZKM ende nuk kishte të aprovuar rregullore apo politikë të shkruar ku do të përcaktoheshin objektivat e saj që do të arrihen me subvencion, si dhe procesin e dhënies dhe monitorimin e tyre. Subvencionet ishin paguar bazuar në marrëveshjet në mes të Zyrës së Kryeministrit dhe përfituesve. Kjo ka ndodhur sepse ZKM vetëm tani është në proces të përpilimit të rregullores për subvencione.

Rreziku Mungesa e rregullores (politikës së shkruar) për subvencione, mos caktimi i kriterëve të qarta për dhënien dhe mënyrën e raportimit të subvencioneve, rrezikon që mjetet e dhëna të mos e tërheqin përfituesin e duhur ose të mos arrijnë qëllimin e duhur duke rezultuar kështu që ZKM të mos i arrijë objektivat e saj.

Rekomandimi 13 ZKA duhet të sigurojë që draft rregullorja është finalizuar dhe aprovuar me atë nivel të detajeve që ofrojnë qartësi mbi procesin e dhënies dhe të monitorimit dhe me përgjegjësi qartë të caktuara edhe për zyrtarët e entitetit edhe përfituesit, rregullore e cila përcakton objektivat dhe kriteret si dhe mënyrën e raportimit nga përfituesit e subvencioneve. Në këtë mënyrë do të garantohej se subvencioni është përdorur për qëllimin e dhënë.

⁹ Manifestimet ishin kryesisht për ditën e pavarësisë, ditën e komuniteteve, dhe të ndryshme.

3.6 Të Hyrat

ZKM së bashku me agjencitë vartëse gjatë vitit 2015 kishte realizuar të hyra në total 5,926,331€. Prej këtij totali 5,576,652€ (apo 94%) ishin realizuar nga AUV.

ZKM kishte vendosur një sistem të mirëfilltë në procesin e mbledhjes, regjistrimit dhe raportimit të të hyrave. Ne kemi testuar 53 mostra të arkëtimeve të të hyrave në total prej 712,495€.

Çështja 14 - Mungesa e softuerit për regjistrimin e të hyrave - Prioritet i mesëm

E gjetura Menaxhimi i të hyrave në AUV në 2015 bëhej në mënyrë manuale. AUV edhe pse kishte filluar procedurat për t'u pajisur me softuer, vonesa në përcaktimin e specifikacionit teknik nënkupton që implementimi është vonuar deri më 2016. Përmes sistemit manual, të hyrat nga pesë lloje të certifikatave regjistroheshin në të njëjtin kod ekonomik.

Rreziku Përpunimi i të hyrave në mënyrë manuale, rritë rrezikun e gabimeve dhe vështirëson procesin e përfitimit të të dhënave të detajuara në kohë për menaxhmentin. Po ashtu edhe regjistrimi i të hyrave në të njëjtin kod vështirëson analizimin dhe menaxhimin e tyre.

Rekomandimi 14 ZKA së bashku me Kryeshefin e AUV-it, duhet të sigurojnë që softueri të funksionalizohet në pajtim me afatet e pritura dhe të mbështetet nga trajnimi adekuat për stafin. Struktura e kodimit ekonomik të rishikohet për të siguruar se i përmbush nevojat biznesore.

3.7 Pasuritë dhe detyrimet

Testuam regjistrimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e pasurive. Një fokus i veçantë ka qenë çështja e regjistrimit në sistemet përkatëse të pasurive siç kërkohet në rregulloret relevante 02/2013, si dhe menaxhimi i veturave zyrtare.

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

ZKM në fund të vitit, kishte pasuri kapitale me vlerë neto prej 2,481,362€, apo 317,829€ më pak se në vitin e kaluar, ku rënia e vlerës ishte rezultat i zhvlerësimit të pasurive dhe blerjet minimale në 2015.

Ne vlerësuar funksionimin e kontrolleve në menaxhimin e pasurive në ZKM duke përfshirë edhe ASK-në, AUV-in dhe AShAK-un.

Çështja 15- Raportimi jo i saktë i pasurive- Prioritet i lartë

E gjetura Pas analizimit të regjistrave të pasurisë në SIMFK dhe në e-pasuri kemi konstatuar se:

- Toka dhe ndërtesa e ASK-së për shkak të pronësisë së trashëguar ende nuk ishin të vlerësuara dhe regjistruara si pasuri. Ndërsa toka ku ishin të ndërtuara objektet e AUV-it nuk ishte regjistruar në kohën e përgatitjes së PVF-ve, megjithatë AUV kishte kryer vlerësimin dhe regjistrimin e tokës në vlerë 1,822,000€ më 26.04.2016;
- Në mungesë të stafit, ABGJ e cila kishte pasuri me vlerë neto 6,347€, si dhe SKSK 12,503€ nuk i menaxhonin pasuritë e tyre përmes sistemit e-pasuria;
- Vlera e stoqeve të AUV në sistemin e-pasuria ishte më e ulët sesa vlera e stoqeve të numëruara nga komisioni i vlersimit për 124,300€. Kjo gjendje ishte si rezultat i stoqeve të bartura ndër vite të cilat nuk ishin regjistruar në e-pasuri. Megjithatë vlera e pasurive jokapitale e prezantuar në PVF paraqet vlerën e dalur nga komisioni.

Rreziku Regjistrimi i dobët i pasurisë mund të rezultoj në gabime në PVF të cilat çojnë në një opinion të modifikuar. Ngjashëm, mund të rezultojë në menaxhim/mirëmbajtje të dobët të pasurisë dhe të çojë në vendimmarrje jo të drejtë në lidhje me to, etj.

Rekomandimi 15 ZKA dhe Kryeshefat Ekzekutiv duhet ta vlerësojnë qartë çdo mangësi në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive dhe të marrin në konsideratë se si mund të adresohen këto çështje. Procedurat e përmirësuara dhe një priorizim i kohës së stafit duhet të zbatohet për të siguruar që e-pasuria është azhurnuar dhe të barazohet me regjistrat e pasurisë.

Çështja 16 - Mungesa e evidencave të plota për përdorimin e automjeteve - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Në dosjet e pesë automjeteve, kërkesa për udhëtime zyrtare nuk ishte aprovuar nga mbikqyrësit përkatës, siç kërkohet me UA 03/2008 për përdorimin e automjeteve zyrtare.
- Rreziku** Mangësitë në plotësim të formularëve sipas UA, ngrisin rrezikun që automjetet të përdoren edhe jashtë qëllimeve zyrtare, në këtë mënyrë shkaktojnë shpenzime shtesë, të paplanifikuara dhe të parregullta, të buxhetit.
- Rekomandimi 16** ZKA dhe Kryeshefat e agjencive duhet të sigurojnë se janë vendosur kontrolle adekuate, që mundësojnë mbikqyrjen e plotë rreth shfrytëzimit të automjeteve sipas kërkesave të udhëzimit përkatës.

3.7.2 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e obligimeve të papaguara të ZKM-së dhe agjencive ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishte 601,909€. Prej tyre 297,155€ ishin obligime të Zyrës për Komunitete për vendimet dhe marrëveshjet e nënshkruara në fund të vitit 2015 për dhënien e subvencioneve, ndërsa pjesa tjetër e tyre ishte rezultat i vonësive në pranimin e faturave dhe mungesës së buxhetit në kategoritë përkatëse. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2016.

Gjatë vitit 2015 nga buxheti i AUV-it ishin ekzekutuar pagesat në vlerë totale 191,922€ me urdhër të përmbaruesit privat për detyrimet nga viti 2010, ku një operator ka mbajtur kafshët në karantinë edhe pas skadimit të kontratës. AUV nuk ishte pajtuar me këtë obligim dhe kishte parashtruar ankesa në të gjitha instancat e gjykatave. Në të njejtën kohë me urdhër të përmbaruesit ishin ekzekutuar nga buxheti i ZKM-së shuma 24,836€, për obligimet e vitit 2012, por që kjo e fundit ishte pajtuar, dhe nuk kishte parashtruar ankesë.

Çështja 17 - Menaxhim jo i duhur i obligimeve - Prioritet i mesëm

E gjetura

Gjatë analizimit të raporteve të obligimeve konstatuam mangësitë:

- Si rezultat i nivelit jo të mirë të kontrolleve si dhe zbatimit të mangët të rregulloreve financiare, ZKM dhe agjencitë e saj kishin hyrë në obligime pa zotim të mjeteve, edhe pse gjatë tërë vitit kishin pasur mjete të mjaftueshme në buxhet;
- Në 27 raste me vlerë totale 243,670€, faturat ishin paguar me vonesë deri në 35 ditë pas afatit ligjor prej 30 ditësh pas pranimit të tyre për shkak të menaxhimit të dobët; dhe
- Raportet mujore të obligimeve të papaguara të ZKM dhe agjencive nuk përfshinin të gjitha faturat e papaguara¹⁰, kjo si pasojë e mos respektimit të hapave që duhet ndjekur në procesin e pagesave.

Rreziku

Obligimet e paplanifikuara reduktojnë fleksibilitetin e buxhetit për 2016. Raportimi jo i plotë i obligimeve mujore pamundësojnë menaxhimin efektiv të buxhetit.

Rekomandimi 17 ZKA dhe Kryeshefat e Agjencive duhet të forcojnë mekanizmat e kontrollit në mënyrë që obligimet të paguhen brenda afatit ligjor dhe të regjistrohen saktë dhe raportohen tek MF me kohë.

¹⁰ Në raportin e muajit janar nuk ishin përfshirë obligimet në vlerë 13,375€, në raportin e marsit 13,316€, raportin e prillit 13,062€ si dhe në raportin e korrikut 4,126€.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo te implementuara	Të pa adresuara
Rreziqet domedhënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare	1.ZKA duhet të shtojë masat e kontrollit të brendshëm për të siguruar se përfituesit e subvencioneve sjellin dëshmi të kompletuara rreth shpenzimit të tyre, në mënyrë që mjetet e dhëna janë shfrytëzuar për qëllimet e caktuara të vendimit të dhënë.			Edhe këtë vit raportimi i subvencioneve ishte përcjellë me mangësi.
Rekomandimet e vitit paraprak	2.ZKA në bashkëpunim me Kryeshefat Ekzekutiv të Agjencive, duhet të sigurojë që plani i veprimit është rishikuar dhe se përcakton qartazi veprimet praktike dhe afatet kohore për adresimin e rekomandimeve, duke përfshirë stafin përgjegjës të identifikuar dhe me fokus fillestar në fushat me mangësi të theksuara.			Niveli i implementimit të rekomandimeve ende mbetet i ulët, po ashtu nuk gjetëm dëshmi formale se në baza periodike është përcjellë implementimi i rekomandimeve.
Qeverisja e mirë	3. ZKA duhet të bëjë një rishikim të rregullimeve ekzistuese të llogaridhënies dhe të kërkesave të raportimit të vendosura mbi agjencitë dhe departamentet, në mënyrë që të sigurohen mekanizma efikase të raportimit për të mbështetur menaxhimin financiar dhe kualitativ në kohë.			Kjo sfidë vazhdon edhe këtë vit, pasi që linjat e raportimit dhe mangësitë tjera ende mbeteshin të njëjta.

Realizimi i buxhetit	4. ZKA së bashku me Kryeshefat ekzekutiv, duhet të sigurojnë që planifikimit buxhetor ti paraprijë një proces rigoroz i vlerësimit që pasqyron plotësisht të gjithë informacionin e duhur, përfshirë rezultatet e vitit paraprak. Nëse vlerësimet buxhetore nuk janë të sakta, të përcaktohen opsione praktike për përmirësim, dhe kjo të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit të vitit vijues.	Këtë vit realizimi i buxhetit ishte dukshëm më i mirë, dhe kishte arritur në nivel prej 91%.		
	5. ZKA dhe Kryeshefi i AUV-it, në bashkëpunim me MF-in duhet të sigurojnë se buxheti/shpenzimi i parasë realizohet vetëm nga kategoria adekuate dhe në këtë mënyrë të kemi një paraqitje të drejtë të pasqyrave financiare.			Ende kryheshin shpenzimet nga kategoria e investimeve kapitale për furnizimet me mallra dhe shërbime.
Të hyrat	6.ZKA së bashku me Kryeshefin ekzekutiv të AUV-it, duhet të sigurojnë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për tu pajisur me një softuer adekuat për menaxhimin e të hyrave. Po ashtu, në bashkëpunim me thesarin të shqyrtohet mundësia për krijimin e kodeve ekonomike për secilin lloj të të hyrave.		Ishte nënshkruar në fillim të vitit 2016 marrëveshja me OE për krijimin e softuerit të AUV-it.	
	7.Kryeshefi Ekzekutiv i AUV, duhet të shqyrtojë arsyet e interesimit të ulët për blerjen e mishit, të analizojë tregun bazuar në informatat e përfituara për rritjen e numrit të ofertuesve në ankande. Në të kundërtën, të shqyrtojë mundësi tjera më të favorshme për trajtimin e mishit nga kafshët e konfiskuara.	Tashmë kjo përgjegjësi kishte kaluar në kuadër të Doganave të Kosovës.		

Shpenzimet përmes prokurimit	8.ZKA dhe Kryeshefat Ekzekutiv duhet të analizojnë arsyet e lëshimeve procedurale të lartpërmendura dhe të shtojnë kontrollet për të evituar përsëritjen e tyre në të ardhmen. Të përgatitet një planifikim adekuat i cili siguron se kërkesat në kategoritë buxhetore janë në përputhëri me kërkesat për blerje.			Edhe këtë vit ishin përsëritur mangësitë rreth zotimit dhe urdhëblerjes pas faturës. Po ashtu edhe blerjet e investimeve kapitale nga mallrat dhe shërbimet.
Prokurimi	9.ZKA në bashkëpunim me Kryeshefat Ekzekutiv, duhet të ndikojnë në shtimin e përgjegjësisë të menaxherët e kontratave, në mënyrë që secili prej tyre të hartojë planin për menaxhimin e kontratës për të cilën është përgjegjës.		Ishte marrë parasysh rekomandimi dhe kishte rënë numri i kontratave pa plan të menaxhimit të tyre.	
Prokurimi	10.ZKA dhe Kryeshefi i AUV, duhet të sigurojnë përmes menaxherëve të prokurimit, se nuk do të bëhet ndarja e prokurimeve të natyrës së njëjtë. Kjo të arrihet duke planifikuar me kohë dhe duke zhvilluar procedurat sipas planifikimit, si dhe të sigurojë që kontratat nënshkruhen vetëm pas kompletimit të dokumentacionit të kërkuar.		Në AUV ishte marrë parasysh rekomandimi dhe nuk ishin zhvilluar procedura të ndara. Kurse në ZKM edhe këtë vit kishte pasur ndarje të procedurave për mallra të teknologjisë informative.	
Shpenzimet jo përmes prokurimit	11.ZKA duhet të sigurojë që respektohen afatet e përcaktuara ligjore për mbylljen e avanseve, gjithashtu të ndikojë në ngritjen e përgjegjësisë tek zyrtarët të cilët i krijojnë këto shpenzime, si dhe të gjitha pagesat për nëpunësit të bëhen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve.			Nuk kishte përmirësime sa i përket mbylljes së avanseve. Edhe këtë vit në ASK nga buxheti për mallra dhe shërbime kompensoheshin nëpunësit e angazhuar në projekte.

Pagat dhe mëditjet	12. ZKA dhe Kryeshefi i AUV-it, duhet të sigurojnë zgjidhje të qëndrueshme për pozitat e mbajtura me ushtrues detyre dhe për pozita të caktuara të sigurohen mundësi të barabarta përmes konkurseve përkatëse.		Tashmë kishte mbetur vetëm një pozitë me ushtrues detyre më gjatë sesa afati i paraparë ligjor.	
Subvencionet dhe transferet	13. ZKA të sigurojë hartimin dhe aprovimin e një rregulloreje, e cila do të përcaktonte objektivat dhe kriteret, si dhe mënyrën e raportimit nga përfituesit për tu siguruar se subvencioni ka arritur qëllimin për të cilin është dhënë.			Ende nuk kishte të aprovuar ndonjë rregullore e cila do të përcaktonte procesin e dhënies dhe monitorimit të subvencioneve.
Menaxhimi i pasurive	14. ZKA dhe Kryeshefat ekzekutiv të agjencive, duhet të sigurojnë dokumentacionin përkatës për vlerësimin dhe regjistrimin e tokës dhe ndërtesave. Po ashtu, të forcohet kontrolli në mënyrë që regjistrimi dhe menaxhimi të kryhet konform rregulloreve dhe të paraqiten vlerat e plota në PVF.		Toka e AUV-së ishte vlerësuar dhe regjistruar në SIMFK në vitin 2016. Pasuritë kapitale gjatë vitit ishin regjistruar në sistem. Megjithatë toka dhe ndërtesa e ASK-së ende nuk ishin vlerësuar dhe regjistruar ende.	
	15. Kryeshefat e agjencive duhet të sigurojnë se të gjitha hyrje-daljet e furnizimeve evidentohen në sistemin e e-pasurisë, në mënyrë që edhe shënimet të jenë të sakta dhe të barabarta me raportet e komisioneve për gjendjen e stoqeve. Gjithashtu në AUV duhet të plotësohet pozita e depoistit.		Ishte plotësuar pozita e depoistit në AUV. Edhe këtë vit kishte mospërputhje të vlerës së stoqeve në e-pasuri dhe vlerës pas numërimit me komision.	

Menaxhimi i automjeteve zyrtare	16.ZKA dhe Kryeshefat e agjencive duhet të sigurojnë se janë vendosur kontrolle dhe mekanizma adekuat që mundësojnë mbajtjen e rregullt të evidencave për shfrytëzimin e veturave zyrtare.			Edhe këtë vit formularët për përdorim të automjeteve zyrtare nuk plotësoheshin konform UA.
Trajtimi i borxheve	17. ZKA dhe Kryeshefat Ekzekutiv duhet të forcojnë sistemin e kontrollit për tu siguruar se të gjitha obligimet evidentohen dhe raportohen brenda afateve të përcaktuara ligjore.			Përsëri kishte pasur rritje të obligimeve në fund të vitit, po ashtu edhe raportet mujore nuk ishin të plota.
Auditimi i brendshëm	18. ZKA duhet të konsiderojë plotësimin e NjAB-it me staf të mjaftueshëm, i cili do të ndikonte në shtimin e sigurisë lidhur me efektivitetin e funksionimit të kontrolleve të brendshme në ZKM			Ende NjAB operonte vetëm me një auditor, duke mbuluar ZKM-në dhe agjencitë e saj.